



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

---

Numri i lëndës: 2022:006381

Datë: 01.02.2024

Numri i dokumentit: 05273186

C.nr.102/2022

C.nr.1826/2023

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtarja Florije Qerimi, me bashkëpunëtoren profesionale Shkurte Kadriu, në çështjen juridike të paditëses K K për D dhe F me E E Sh.A (K), me seli në P, kundër të paditurit G (E) J nga Gj, Rr.“A.T”, p.nr., të cilin e përfaqëson Elbasan Alidema avokat nga Gjilani, me objekt kontesti kompensim i dëmit material, jashtë seancës gjyqësore, me datën 31.01.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET marrëveshja për Zgjidhje të Ndërmjetësuar e arritur në Gjilan, me numër të ref.së ndërmjetësimit ND.34/2024, me datë 30.01.2024, në çështjen kontestimore C.nr.102/2022, të paditëses K K për D dhe F me E E Sh.A (K), me seli në P, kundër të paditurit G (E) J nga Gj.

II. Marrëveshja e arritur nga palët ndërgjyqëse përmes procedurës së ndërmjetësuar e cekur në pikën I të këtij dispozitivi, në kuptim të nenit 15 par.1, të Ligjit për Ndërmjetësim, e ka fuqinë e dokumentit përmbarues, sipas ligjit përkatës për procedurën përmbarimore.

A r s y e t i m

Paditësja K K për D dhe F me E E Sh.A (K), me seli në ka paraqitur padi C.nr.1826/2023 të datës 10.10.2023 dhe C.nr.102/2022 të datës 13.01.2022 kundër të paditurit G (E) J nga Gj, me objekt kontesti kompensim i dëmit material.

Gjykata me aktvendimin C.nr.102/2022 të datës 07.12.2023 ka bërë bashkimin e lëndëve C.nr.1826/2023 dhe C.nr.102/2022, ashtu që lëndët e bashkuara do të evidentohen me C.nr.102/2022.

Gjykata duke u bazuar në dispozitat e Ligjit nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim këtë lëndë, e ka dërguar për zgjidhje në procedurë të ndërmjetësimit pranë Gjykatës Themelore në Gjilan, me ç’rast Qendra e Ndërmjetësimit pas zhvillimit të procedurës së ndërmjetësimit me datë

30.01.2024, i ka dërguar gjykatës lëndën së bashku me marrëveshjen e arritur nga palët ndërgjyqëse për zgjidhje të ndërmjetësuar me numër të ref. së ndërmjetësimit ND.34/2024 të datës 30.01.2024.

Gjykata pasi ka pranuar marrëveshjen e palëve për zgjidhje të ndërmjetësuar me numër të ref. së ndërmjetësimit ND. 34/2024 të datës 30.01.2024, konstatoi se kjo marrëveshje i plotëson kushtet e parapara ligjore sipas Ligjit nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, dhe si rrjedhojë të njëjtën e aprovoi.

Nga arsyet e cekura dhe bazuar në dispozitën e nenit 411 parag.1 të LPK-së, nenit 8 parag.1, nenit 15 parag.1 të Ligjit nr. 06/L-009 për Ndërmjetësimin, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr.102/2022, me datë 31.01.2024

Gjyqtarja,  
Florije Qerimi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.